



REPUBLIKA E SHQIPËRIË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV**

Nr. 859 / Prot.

Tiranë më 23.7.2019

REKOMANDIM

Nr. 35, datë 23.7.2019

PËR KONTROLLUESIN "OSUMI TRAVEL SH.P.K"

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 a/1 dhe 32 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Osumi Travel sh.p.k*".

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr.190 datë 17.06.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, më datë 21.06.2019 u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit "*Osumi Travel sh.p.k*", me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "*Osumi Travel sh.p.k*", konstaton se:

1. Kontrolluesi ka paraqitur një "*Formular Njoftimi*" të plotësuar në vitin 2016, nga ana e Kontrolluesit "*Osumi sh.p.k*". Sikurse vërtetohet në QKB, nga ekstrakti i regjistrit tregtar për të dhënat e subjektit, "*Osumi Travel sh.p.k*" ka numër unik identifikimi (NUIS) të ndryshëm nga ai i "*Osumi sh.p.k*". Në rastin konkret, Formulari i Njoftimit duhet plotësuar nga e para për kontrolluesin "*Osumi Travel sh.p.k*", si një detyrim ligjor që duhet përmbushur më vete nga Formulari i "*Njoftimit*" të plotësuar nga "*Osumi shpk*" në 2016, në zbatim të nenit 21, të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.

"Njoftimi" mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat kontrolluesi është përgjegjës, është i rëndësishëm pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi kategorinë e të dhënave që përpunohen, qëllimin e përpunimit të tyre, realizimin e detyrimeve ligjore nga ana e kontrolluesit etj.

2. Kontrolluesi ka një Rregullore të brendshme "*Për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale*". Megjithatë vlerësohet se përmbajtja e kësaj rregullore është përmbajtje e një Politike Privatësie dhe jo e një Rregullore të mirëfilltë "*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*". Kontrolluesi këtë përmbajtje e ka të afishuar edhe në faqen <http://www.osumitravel.al/>. Megjithatë konstatohet se kjo faqe nuk përdoret nga ana e "Osumi Travel shpk".

Duhet kuptuar drejt nga kontrolluesi rëndësia që ka hartimi dhe përdorimi nga nëpunësit e tij të një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, si një akt bazë i cili ndërgjegjëson dhe sqaron punonjësit për të dhënat personale, rëndësinë e tyre, ruajtjen e fshehtësisë si dhe mënyrën e administrimit të tyre. Për këtë arsye duhet të hartohet një rregullore e detajuar e cila të jetë e zbatueshme në praktikë dhe të reflektojë edhe masa konkrete, sipas standardit të parashikuar.

3. Kontrolluesi ka një sistem video-survejimi (CCTV), të përbërë nga 3 kamera. Afati i ruajtjes së imazheve është 7 ditë. Kontrolluesi njofton klientët dhe punonjësit në lidhje me praninë e sistemin CCTV, me anë të tabelave informuese në hyrje të ambientit, në përmbushje të detyrimit të parashikuar në nenin 18, të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar. Megjithatë, tabelat nuk janë sipas standardit të Udhëzimit nr.3, datë 05.03.2010 "*Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise te tjera*", të Komisionerit.
4. Kontrolluesi nuk ka nënshkruar Deklaratat e Konfidencialitetit me punonjësit efektiv dhe të larguar, sipas standardit të Vendimit nr.06, datë 05.08.2013, të Komisionerit. Gjithashtu, edhe nga verifikimi i kontratave individuale të punës nuk gjendet asnjë dispozitë për ruajtjen e konfidencialitetit, detyrim i parashikuar në nenin 28, të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.

Qëllimi i nënshkrimit të kësaj deklarate është fakti që të gjithë punonjësit të cilët kanë akses në informacione lidhur me të dhënat personale, të tyre apo të klientëve, të kuptojnë qartë dhe drejtë detyrimet që ata kanë për ruajtjen e konfidencialitetit. Në aktin e formalizuar me titull "*Deklaratë Konfidencialiteti*", dalë në zbatim të Vendimit nr.06/2013, të Komisionerit "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*", merren përsipër të drejta dhe detyrime lidhur me mos transferimin në mënyrë abuzive të të dhënave personale tek personat e paautorizuar. Me nënshkrimin e një akti të tillë, synohet ndërgjegjësimi i plotë i deklaruesit ndaj punëdhënësit për ruajtjen e të dhënave personale, të dhënat që i

mëson për shkak të detyrës apo pozicionit që ka, si dhe paralajmërohet marrja e masave të menjëhershme administrative në rast të shkeljes së këtij standardi.

5. Kontrolluesi ka nënshkruar Kontratë me Kompani të treta, për sigurinë e ambientit. Kopjen e Kontratës së Shërbimit nuk e dispononte.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit ka hartuar procesverbalin e konstatimit, datë 21.06.2019, i cili u lexua dhe u nënshkrua në prani të palëve. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesi i kontrolluesit parashtrroi këto pretendime në procesverbal: *“U vura në dijeni për Kontrollin, pretendimet Zyrtare do t'i paraqesim të hënën pranë Zyrës së Komisionerit”*.

Kontrolluesi, më datë 21.06.2019 ka dërguar në rrugë elektronike, në cilësinë e provës materiale kopje të plotësuara të Formularit të *“Njoftimit”*, Deklaratën e Konfidencialitetit, rregullore specifike *“Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”*, Kontratën e shërbimit për sistemin e kamerave sipas standardit të parashikuar në Udhëzimin nr.19, datë 03.08.2012 *“Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e delegimit të përpunimit të të dhënave dhe përdorimit të një kontrate tip në rastet e këtij delegimi”*, ndryshuar me udhëzimin nr.30 datë 27.12.2012. Kontrata me palët e treta mbante datën 02.05.2019.

Në zbatim të neneve 87-89, të ligjit nr.44/2015 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, kontrolluesi *“Osumi Travel sh.p.k”* është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore, në datën 02.07.2019, pranë ambienteve të Zyrës së Komisionerit. Përfaqësuesi i kontrolluesit është paraqitur në seancë dëgjimore dhe është shprehur se para ushtrimit të hetimit administrativ nuk ishte në dijeni të detyrimeve ligjore dhe ka reaguar menjëherë duke i përmbushur konstatimet e procesverbalit.

Zyra e Komisionerit ka marrë në konsideratë faktin që pranë kontrolluesit nuk është kryer hetim administrativ i mëparshëm, bashkëpunimi i treguar me grupin e kontrollit si dhe reagimi i menjëhershëm pas konstatimit të shkeljeve.

Megjithatë, kontrolluesi duhet të mbajë parasysh përshtatjen e rregullores standarde me aktivitetin e ushtruar si dhe të përditësojë Formularin e Njoftimit përsa i përket rubrikave *“Kategoritë e subjekteve të të dhënave”*, *“Qëllimi i përpunimit”* dhe *“Marrësi i të dhënave personale”*. Gjithashtu, ky përditësim duhet kryer sa herë kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit dhe përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 21, 27, 29, 30, 31 dhe 32 pika 1 të ligjit nr. 9887/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi *“Osumi Travel sh.p.k”*, të ketë në vëmendje përditësimin e Formularit të *“Njoftimit”* pranë Zyrës së Komisionerit, në lidhje me rubrikat *“Kategoritë e*

subjekteve të të dhënave”, “Qëllimi i përpunimit” dhe “Marrësi i të dhënave personale”, në zbatim të nenit 21, të ligjit nr.9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

2. Kontrolluesi “Osumi Travel sh.p.k”, të përmirësojë rregulloren e brendshme në përputhje me veprimtarinë e ushtruar duke parashikuar masa konkrete organizative dhe teknike për të mbrojtur të dhënat personale, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat dhe aksesin në të dhëna etj., në zbatim të nenit 27, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar dhe Vendimit nr.6/2012 të Komisionerit “Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”.
3. Kontrolluesi “Osumi Travel sh.p.k” të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 30 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
4. Në rast mos përbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të ligjit nr. 9887/2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 23.7.2019.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

